



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LIBOHOVË
SEKTORI I SHERBIMEVE BUJQESORE, VETERINARE DHE MJEDISORE

Nr. 538 Prot

Libohovë, më 19.03.2026

Lënda: Informacion.

Drejtuar; Këshillit Bashkiak Libohovë

Per sa i perket fushes se bujqesise:

Bashkia Libohovë ka në teritorin e saj 3240 ha tokë bujqësore nga e cila 2470 ha e ndarë me AMTP dhe pjesa tjetër ka ngelur tokë e pa ndarë e cila ndodhet ne Njesinë Administrative Qëndër dhe ne Njesine Administrative Zagorie , afersisht 800 ha e cila eshte e pandare. 95 ha eshte dhene nga bashkia per mbjelljen e kulturave drufrutore dhe pjesa tjeter eshte e lire dhe ne fondin ekompensimit fizik .

Nga tokat e ndara me AMTP kultivohet rreth 50% e saj , nga struktura vendin e pare e zene kulturat foragjere , ne vend te dyte drithrat ,ullinje ,peme frutore ,vreshta ,perime .

Gjate vitit 2026 siperfaqja e kultivuar me grure dhe elb eshte 82 ha ne keto kultura jane kryer sherbimet si dhe pleherimi azotik gjithashtu siperfaja prej 64ha e mbjelle me tershere ushqim per blegtorine dhe nje siperfaqe prej 40 ha eshte lene per prodhim per koker ne kete siperfaqe eshte kryer pleherimi azotik ka perfunduar dora e pare dhe vazhdon dora e dyte Mbjellja e kultures se jonxhes vazhdon dhe deri ne kete periudhe jane mbjelle nje siperfaqe prej 10ha Ne jonxhat e vjetra eshte kryer pleherimi si dhe kullimi siperfaqesor nga fermeret.

Ka filluar gjithashtu pregatitja per mbjelljen e kultures se misrit ku per kete kulture eshte pluguar nje siperfaqe prej 8ha

Eshte bere pleherimi baze I siperfaqeve qe do te mbillen me kete kulture dhe vazhdon puna per pregatitjen e tokes.

Siperfaqja nën kanalin vadites V2 është e gjitha e ujiteshme po kështu skema ujites e fushes se Bulos dhe e fushes se Suhes jane ne kushte normale . .

Ne fushen e Laboves ujitin rreth 10 ha probleme te cilat kekojne nderhyrje ka kanali furnizues i liqenit si dhe ka humbje nga diga ne pjesen perendimore te saj pasi ka zgavra dhe mbushja e tij behet ne masen rreth 60% te kapacitetit . Leshuesi dhe shkarkuesi i ketij liqeni eshte ne gjendje te mire dhe funksional. Gjate sistemit te ujitjes vitin e kaluar jane evidentuar disa probleme si nderhyrje ne kanalin vadites V2 mungese pruzash ,si dhe vendosje prizash me kapacitet me te vogel qe nuk perputhen me standartin e kerkuar dhe shkaktojne humbje te sasise se ujit problematika qe i jane bere me dije sektorit te bordit te kullimit Gjirokaster i cili ka ne pronesi kete kanal . perkete eshte kerkuar nga drejtuesit e ketij institucioni pastrimi I ketij kanali dhe rregullimi I prizave me probleme. Kerkesa per bashkerendimin e punes me kete institucion eshte realizuar dhe po punohet per realizimin e detyrave.

Liqeni i Doftise eshte ne gjendje te mire persa i perket sasise se ujit te grumbulluar dhe reshjet e rena ditet e fundit e kane ritur nivelin e tij i cili po shkon ne kuota maksimale po kështu edhe ne zonene e fshatit Bulo sistemi ujites i kesaj fushe eshte ne parametra normal Ne fushen e Suhes gjendja e skemes ujitje -kullim eshte e mire funksionale ne kete fushe ka ngelur pa pastruar vetem kanai ujites i Argjinatures Liqeni i Suhes eshte ne gjendje te mire dhe ne nivel mbushje afer kuotave maksimale te ky liqen nga monitorimi qe behet ne menyre sistematike diga , shkarkuesi , leshuesi dhe furnizuesi jane ne gjendje te mire. Kanalet ujites ne pronesi te bahkise jane 70,4 km jane te pastuar dhe ne gjendje funksionale 30,4km 40km jane jashte funksionit.

Në fushen e kullimit bashkia ka ne pronesi 72 km kanale kulluese te dyta dhe te treta keto shumica ndodhen ne pjesen e poshteme te territorit te bashkise dhe qe kultivohet dhe ka nevojë per nderhyrje .

Per vitin 2026 sektori i bujqesise ka parashikuar te nderhyje ne kanalet e meposhteme ;

K2-1,K 2-2,K2-6 te cilet ndodhen ne fushen e Libohoves . Gjatesia e nderhyrjes ne kete zone(Kaperxhi, , ish Pyjorja eshte 1km) zonen cilister riparim I skemes ujites

Gjthashtu jane parashikuar nderhyrje ne kanalin vadites mulliri i Suhes Karamane dhe ushqyesi i rezervuarit te Laboves ne keto kanale punimet nuk jane realizuar akoma.

STRUKTURA E MBJELLJEVE

Struktura e mbjelljeve per Bashkine Libohove ende nuk ka perfunduar pasi eshte heret dhe mbjelljet e pranveres nuk kane perfunduar ka siperfaqe te vogla te mbjella kryesisht me jonxhe si dhe siperfaqe te vogla te mbjella me patate e perime kryesisht per plotesim te nevojave familjare gjithashtu jane kryer plugimi i siperfaqeve qe do te mbillen me miser, sherbimet ne drufrutore e vreshta e ullinj si dhe pleherimi baze. Siperfaqja e mbjelle me miser mendohet te jete ne kuotat e vitit te kaluar. Kushtet atmosferike te diteve te fundit nuk kane favorizuar ecjen e punimeve per mbjelljet e pranveres kryesisht te jonxhes e cila ka ngel mbrapa dhe po i ikcn afati optimal i mbjelljes se kesaj kulture .Perfundimi i struktures se mbjelljeve do te shtyhet ne muajin maj.

Ne fushen e keshillimit bujqesor specialistet prane bashkise kane punuat per orjentimin e fermereve me metodat shkencore ne fushen e struktures se mbjelljeve llojeve menyren e kultivimit dhe ne fushen e mbrojtjes se bimeve . Gjithashtu eshte bere edhe takim informues me bashkepunimin e DRB,AZhBRN Gjirokaster ne lidhje me sqarimine e skemave mbeshtetese per bujqesine per vitin vijues 2026 .

Specialisti i Bujqesise
Filip Zera



Specialisti i Bujqesise
Arlind Kënaçi



Specialisti i Bujqesise
Llazar Meksi



Nr 566 Prot
D. 24.03.2026.
SEK.
BASHKIA



REPUBLIKA E SHQIPËRI SË

BASHKIA LIBOHOVË

SEKTORI I TATIM TAKSAVE

ANALIZE

MBI TE ARDHURAT PER VITIN 2025.

Puna e zyrës së tatim taksave është bazuar në ligjin nr 139/2015 "Per vetqeverisjen Vendore, ligjin nr.9632 date 30/11/2006 "Per sistemin e taksave vendore", I ndryshuar me ligjin nr.142/2015 ligjin nr.9920 date.19/05/2008 "Per procedurat ne Republiken e Shqiperise I ndryshuar"si dhe vendimeve te Keshillit Bashkiak Libohove.

Zyra e tatim taksave ne bashkepunim me zyrat e tjera ka hartuar planin e te ardhurave per vitin 2025,per taksat dhe tarifate ne baze te ligjeve ne fuqi dhe vendimeve te keshillit nr 66 date 22.11.2024. Pas miratimit te ketyre vendimeve nga keshilli bashkiak dhe konfirmimit nga Prefektura e Qarkut ,zyra ka filluar punen per zbatimin e tyre.

Plani per vitin 2025 eshte miratuar ne shumen 14.066.100 (Katermbdhjet milion e gjashtedhjet e gjashte mij e njqind) leke. Realizimi i te ardhurave nga taksat dhe tarifate vendore per vitin 2025 eshte realizuar ne shumen 14.284.620 (katermbdhjet milion e dyqind e tetedhjet e kater mije e gjashteqind e njezet leke ose 101.5 %.

Ne tabelen e pare eshte pasqyruar plani dhe realizimii ndare sipas taksave dhe tarifave vendore per vitin ushtrimor,kurse ne tabelen e dyte eshte debia nga vitet e prapambetura dhe arketimet deri ne 31.12.2025.,dhe kjo e ndare sipas llojit te taksave dhe tarifave.

PLANI DHE ARKETIMET PER VITIN USHTRIMOR 2025

	Gjendja	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qersho	Korik	Gusht	Shtato	Tetor	Nentor	Dhjetor	Shuma
Nd.Fa	1412700	18794	14231	40643	22006	8944	36342	35413	90586	177082	118066	73030	134829	769966
Nd.Priv	691300	1080	190674	11510	30052	21705	177633	44190	63385	84177	14441	7128	39321	685296
T.Bujq	2021000	31088	22589	74544	51752	19148	88435	62803	117620	322206	185824	120373	229899	1326281
Nc.Infr	400000			308478	55720		139440	28374	1957	244162		38992		817123
Rr.Auto	3000000	692950	235117		233793	145442	170158	192048	277350	238071	203805	257291	282275	2928300
Tr.Fam	158600	2388	1360	5773	3779	1468	7114	2734	10356	11864	7489	9421	16079	79825
Tr.Biz	179400		59700		8160		87600	15800	3600			2400	2140	179400
Ndr.Fa	482400	9500	7200	20200	18400	6742	16700	17400	42000	121800	69000	38400	78000	445342
Ndr.Biz	91600		5400	5400	7200	7800	3600	6150	9000	19800	9000	1800	13050	88200
Pas.Fa	1508400	18000	14400	38400	39000	12000	31600	38400	67800	243600	121200	57600	141000	823000
Pas.Biz	606600	5000	115000	40000	90000	21700	60000	29100	42500	77500	30000	10000	85800	606600

F-B/M	430000	26300					29100	81400		26000	39500	36700	72800	311800
Tar Uj	600000							45600	69000	30000	58800	21000	61200	285600
Z/H/P	34100		2800	36000				18840						57640
T.V.K	200000				200000									200000
Q/T/B	380000		8640	3360	6460	10680		25966			139440		113940	308486
Qera Tr	450000			225000		75000			75000			75000		450000
T A Per	1200000				142556			709839			770940		529233	2152568
T.J.T	220000	1200	3650	9000	34856	72215	13400	10338	15007	26300	11446	19899	29575	246886
SHUM A	14066100	806300	680761	818308	943734	402844	861122	1364395	885161	1622562	1778951	769034	1829141	12762313

DEBIA DERI NE 31.12.2024,DHE ARKETIMET GJATE VITIT USHTRIMOR 2025

	Gjendja	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	Shuma
T.Bujq	7312385	65249	34980	57414	40141	26262	27002	32301	30341	19191	23385	56636	48620	461522
Nd Fa	4252203	17298	34697	28951	45788	14331	8855	31492	40964	15120	22045	26739	33422	319702
Nd Biz	294736	1080				3240			2025	24104				30449
Tr.Fam	492907	4490	2982	1771	4661	1948	649	1668	4449	1213	1259	5597	8390	39077
Tr Biz	86400								0					0
Ndr Fa	1200840	6660	6420	7000	11140	3180	1600	8220	12120	740	5140	5200	5820	73240
Ndr Biz	20640		1800			1800			720	3600				7920
Pas.Fa	2015130	39100	25400	17500	21200	7400	3600	11000	22800	1700	6900	9200	19700	185500
Pas.Biz	156750	5000	5000			5000			5000	25000				45000
Biz Vog	3891831		20000							79840				99840
Tar Uj	1251200				17400		12000	7200		84000	30000	34000		184600
Z.H.P	5920													0
Tar Ble	412340													0
Q/T/B	222240								43680					43680
K.Vone	2858254	270	660	2251	8594					14865	1645	3492		31777
SHUM A	24473776	139147	131939	114887	148924	63161	53706	91881	162099	269373	90374	140864	115952	1522307
	945447	812700	933195	1092658	466005	914828	1456276	1047260	1891935	1869325	909898	1945093	14284620	

Ne Bashki kryejne aktivitet gjithsej 57 subjekte private me aktivitete te ndryshme dhe jane te ndara si me poshte:

	Gjithsej	Arketuar	Debitor
Bashkia Libohove	40	40	0
NJ.A.Q	14	14	0
NJ.A.Z	3	3	0
	57	57	0
NE VLERE	1516332	1516332	0

Persa l perket vetem planit per familjaret qe perfshin taksen e tokes bujqesore,taksen e ndertesese,taksen e truallit si dhe tarifen e ndricimit dhe te pastrimit kemi kete plan dhe realizim ne leke dhe ne perqindje e ndare sipas Njesive Administrative.

	Plani	Realizimi	Mbetje	Ne %
Libohove	2747247	1283086	1464161	47
NJ. A. Q	2283046	1725110	557936	75
NJ. A. Z	664529	370543	293986	56
	5694822	3378739	2316083	59

Lidhur me sa më lart, do të paraqesim shkurtimisht arsyet që motivojnë shifrat e pasqyruara në këtë analizë. Siç shihet edhe nga të dhënat tabelare, realizimi i planit është në masën 101.5%, për vitin ushtrimor 2025 në total nga të gjitha burimet e të ardhurave kemi një realizim 91%.

Realizimi i dobët reflektohet në taksat dhe tarifën për familjarët. Nga ana e punonjësve të zyrës është bërë një punë këmbëngulëse dhe e vazhdueshme për arkëtimin e taksave, duke kryer fushatën të herëpashershme për mbledhjen e tyre në çdo fshat. Megjithatë, konstatohet se, pavarësisht punës së kryer, debia vazhdon të ngelet për disa arsye, mes të cilave më kryesorja lidhet me largimin masiv të popullatës nga zonat rurale përgjatë viteve, çka ka vështirësuar së tepërmi punën për arkëtimin e tyre, veçanërisht në fshatrat e NJ.A Zagori, NJ.A.Qender, por problematike paraqitet gjendja edhe në qytetin e Libohovës.

Persa i përket taksave lidhur me token bujqesore vlen të theksohet një problematikë si vijon: AMTP-të janë në emer të atyre që e kanë përfituar token në bazë të ligjit 7501 si pjesë e familjeve bujqësore, ndërkohë që pavarësisht nga shrytezimi që i bëhet asaj, askush nuk merr përsipër të kryejë pagesat, duke qenë shumica e tokave në bashkëpronësi.

Përgjigjësi i zyrës

Xhevahir SINANI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LIBOHOVË
SEKTORI I KULTURËS ARSIMIT DHE MIRËQËNIES SOCIALE

Nr. 484 Prot

Libohovë, më 11.03.2026

Lënda: Projekt –vendim për mbledhjen e këshillit bashkiak.

SEKRETARI I KËSHILLIT TË BASHKISË
LIBOHOVË.

- 1.Projekt –vendim, për dhënien e ndihmës, nga fondi 6%, për muajin shkurt 2026.
- 2.Projekt –vendim, për dhënien e ndihmës nga fondi i bashkisë shkurt 2026.

Ju faleminderit për bashkëpunimin.





REPUBLIKA E SHQIPËRI SË

BASHKIA LIBOHOVË
SEKTORI I KULTURËS ARSIMIT DHE MIRËQËNIES SOCIALE

Nr. Prot

Libohovë ,më 11.03.2026

PROJEKT- VENDIM

Nr 3 datë, 11/03/2026

PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI 6% PËR FAMILJET JO FITUESE NGA SKEMA E NDIHMËS EKONOMIKE.

Bazuar në vendimin nr. 955, datë 07.12.2016” Për përcaktimin e kritereve , të procedurave, dokumentacionit dhe masës së ndihmës ekonomike”, në udhëzimin nr.5,datë 17.02.2017.”Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6 për qind”, në udhëzimin nr 4 datë 17.02.2017 “ Për përlllogaritjen e përfitimit të ndihmës ekonomike” Ligjin 57/2019”Për asistencën sociale në RSH”,VKB Libohovë, nr.3datë 24.01.2025 “Për përcaktimin e kritereve për familjet në nevojë” ,mbështetur në vlerësimin ekonomik –social, propozojmë Këshillit Bashkiak ,për muajin shkurt 2026, familjet që do të përfitojnë nga fondi i kushtëzuar 6%.

Nr	Emri Atesia Mbiemri	Muaji	Shuma/lek
1	Ferdi Sejfulla Ruli	shkurt 2026	2178

Për zbatim të këtij vendimi ngarkohet Zyra e Ndiemes Ekonomike.
Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë.

Spektori Shërbimit Social
Majlinda Gjika

KRYETARI
Leonard HIDE



Juristi
Kristaq Ciko



Prefektura Gjirokaster
Bashkia Libohove,Libohove

LISTË

"LISTA E FAMILJEVE/INDIVIDËVE NË NEVOJË TË REKOMANDUAR PËR TRAJTIM ME FONDIN 6% PËR PERIUdhËN Shkurt/2026

Struktura përgjegjëse për shërbimet sociale në Njësinë Administrative Libohove,Libohove rekomandon listën e plotë të familjeve/individëve në nevojë për trajtim me fondin 6%.

Nga dokumentacioni i paraqitur, si dhe nga verifikimet e kryera konkludojmë se:

-Janë rekomanduar për trajtim me fondin 6% 1 familje, lista bashkëlidhur.

Prefektura Gjirokaster
Bashkia Libohove,Libohove
Personi përgjegjës për ndihmën ekonomike
Emri, Mbiemri firma
MAJLINDA GJIKA

Lista e plotë e familjeve të rekomanduara për trajtim me fondin 6% për periudhën e akorduar.

Nr.	Emri Atësia Mbiemri	Fondi 6%(Vlera)	Kompensimi i Energjisë(Vlera)	Statusi
1	Ferdi Sejfulla Ruli	2178.00	-	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LIBOHOVË

SEKTORI I KULTURËS ARSIMIT DHE MIRËQËNIES SOCIALE

Nr. Prot.

Libohovë më 11.03.2026

PROJEKT-VENDIM

Nr 02 datë 11/03/2026

PROPOZIM PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I VETË BASHKISË PËR FAMILJET JO FITUESE NGA SKEMA E NDIHMËS EKONOMIKE.

Duke u mbështetur në nenin 27/1 të Ligjit 9355, datë 10.03.2005 "Për ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore" i ndryshuar me Ligjin 44/2016 datë 21.04.2016 , në pikën 7 të Kreut II të Vendimit nr.955, datë 07.12.2016 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike", ndryshuar me VKM nr. 597 datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" Ligjin 57/2019 "Për asistencën sociale në RSH", VKB Libohovë, nr.3 datë 26.01.2026 "Për përcaktimin e kriterëve për familjet në nevojë" në bazë të propozimit të paraqitur nga zyra e Ndihmës Ekonomike ,miratuar nga Kryetari i Bashkisë Libohovë , familjet në nevojë që kane dale jo fitues nga skema e ndihmës ekonomike, ose që nuk mund të aplikojnë, të përfitojne nga fondet e vete Bashkisë .

Propozojmë Këshillit Bashkiak.

Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i akorduar nga bashkia familjet e mëposhtme.për muajin shkurt 2026.

	Emer,mbiemer	Arsyct	LEKË
1	Josif Proko	Person i vetëm, jeton në Zagoric	5000
2	Marika Mino	Person i vetëm, jeton në Zagoric	5000
3	Vilson Buzo	Prind i vetëm me 3 fëmijë të mitur	5000
4	Ferdî Ruli	Person i vetëm ,I paaftë për punë	3000
5	Gjergji Ruli	Person i I paaftë për punë	5000
6	Fredi Proko	Person i I paaftë për punë	5000
7	Rusho Maçi	Person i paaftë për punë	5000

8	Enkelelda Matushi	Prind i vetëm me fëmijë të mitur	5000
9	Madrit Avduli	Prind i vetëm me 2 fëmijë të mitur	5000
10	Zenel Çobani	Person i paaftë për punë	5000
11	Resul Sinani	Person i I paaftë për punë	5000
12	Shqiponjë Myftaraj	Prind i vetëm me 2 fëmijë të mitur	5000
13	Afërdita Mërtiri	Person i vetëm, jeton në Zagorie	5000
14	Rigels Ruli	Kryefamiljar ne nevojë	5000
15	Niko Karavidha	Person i paaftë për punë	5000
16	Gani Ruçi	Prind i vetëm me 1 fëmijë të mitur	5000

Luten anëtarët e Këshillit Bashkiak të miratojnë ose jo dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i bashkisë për muajin shkurt 2026

Spektori Shërbimit Social
Majlinda Gjika




Juristi
Kristaq Çiko





REPUBLIKA E SHQIPËRI SË

BASHKIA LIBOHOVË
SEKTORI I KULTURËS DHE MIRËQËNIES SOCIALE

Nr. 479 Prot.

Libohovë, më 10.03 2026

Drejtuar : Këshillit Bashkiak

Lënda : Relacion për mbajtjen hapur të kopshtit Nepravishtë.

RELACION

I nderuar kryetar! Të nderuar këshilltarë dhe pjesëmarrës!

Bazuar në ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, shkronjës c të pikës I të udhëzimit nr.14, datë 10.07.2023 “për numrin e nxënësve për klasë dhe ngarkesën mësimore të punonjësve arsimorë në institucionet e arsimit parauniversitar” ku citohet se: **“Grupet e përziera të nxënësve në zonat rurale të formohen me jo më pak se 10 nxënës që frekuentojnë. Në rastet kur ky numër nxënësish nuk sigurohet, mund të formohet grup me jo më pak se 5 nxënës që frekuentojnë kopshtet, pas mendimit pozitiv të njësive të vetëqeverisjes vendore”**, kërkojmë nga Këshilli I Bashkisë miratimin e projekt-vendimit për të mbajtur hapur kopshtin Nepravishtë.

Kopshti Nepravishtë ka aktualisht 6 fëmijë që frekuentojnë, duke u nisur nga baza ligjore dhe distanca (8.9 kl) e fshatit Nepravishtë nga kopshti nr.1, ku është i pamundur transferimi i fëmijëve nga kopshti Nepravishtë në kopshtin nr.1 Libohovë, kërkojmë që gjendur në këto kushte, **Kopshti Nepravishtë të qëndrojë i hapur.**

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin.

Specialisti i Arsimit dhe Kulturës

Arjan Çano



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBOHOVË

P/VENDIM

Nr. ___ datë __. __. 2026

PËR MBAJTJEN HAPUR TË KOPSHTIT NEPRAVISHTË

Lënda : Relacion për mbajtjen hapur të kopshtit Nepravishtë.

I nderuar kryetar! Të nderuar këshilltarë dhe pjesëmarrës!

Bazuar në ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, shkronjës c të pikës I të udhëzimit nr.14, datë 10.07.2023 “për numrin e nxënësve për klasë dhe ngarkesën mësimore të punonjësve arsimorë në institucionet e arsimit parauniversitar” ku citohet se: **“Grupet e përziera të nxënësve në zonat rurale të formohen me jo më pak se 10 nxënës që frekuentojnë. Në rastet kur ky numër nxënësish nuk sigurohet, mund të formohet grup me jo më pak se 5 nxënës që frekuentojnë kopshtet, pas mendimit pozitiv të njësive të vetëqeverisjes vendore”**, kërkojmë nga Këshilli I Bashkisë miratimin e projekt-vendimit për të mbajtur hapur kopshtin Nepravishtë,

VENDOSI:

1. Kopshti Nepravishtë të qëndroj I hapur në shërbim të fëmijëve të fshatit Nepravishtë.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Zyra e Arsim-Kulturës.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55 pika 6, e ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.

SPECIALISTI

Arjan Çano

JURISTI

Kristaq Ciko



KRYETARI

Leonard Hida

Nr 536 Prot

11.18.03.2026



KËSHILLIT BASHKIAK LIBOHOVË

Z. Leonard Hide

KRYETAR I BASHKISË LIBOHOVË

Për djeni :PREFEKTIT TË QARKUT GJIROKASTËR

Ankesë mbi Vendimin e Këshillit Bashkiak Libohovë për shpronësimin e tokës bujqësore.

Jam Mujo Ruçibanues në Libohovë .

Kam përfituar tokë bujqësore nga ligji 7501/1991 “Për tokën”

Mbi sipërfaqen prej 4500 m² bashkia Libohovë ka ngritur landfillin në vitin 2020 , pa marrë parasysh se kjo sipërfaqe ishte mbi tokën bujqësore me pronar .

Pas shumë vështirësisht dhe kohe mora dokumentacionin e pronësisë nga ASHK – ja ku njihem si pronar i ligjshëm, të cilin e dorëzova në bashki , pasi që prej ndërrimit të landfillit bashkia nuk e konsideronte si dokumentacion pronësie AMTP .

Në mbledhjen e fundit të Këshillit Bashkiak është marrë Vendimi për shpronësimin e kësaj toke dhe dëmshpërblimin e pronarit.(në këtë rast ndaj meje)

Sipas këtij Vendimi çmimi i tokës për m² është vlerësuar me 150.2 lekë (njëmijë e pesëqin ë njëzet lekë të vjetra) .

Përcaktimi i këtij çmimi është në kundërshtim me VKM nr 313 /2023 për disa ndryshime ne VKM nr 233 datë 23 .12.2016 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për vlerësimin dhe ekzekutimin e vendimeve përfundimtare të kompensimit të pronës shpërndarjen e e fondit financiar e fizik për kompensimin e pronave “ Kreu I pika 3/d “ për përcaktimin e zërit kadastral në kohën e shpronësimit”

Theksoj se pavarësisht se kjo VKM është për Agjencine e Trajtimin të Pronave, parktika për shpronësim është e njëjtë dhe për Njësitë Vendore.

Grupi i punës në bashki për vendosjen e këtij çmimi qesharak nuk është mbështetur në ligj , por me tendence jo logjike dhe dashakeqe, pasi dhe çmimi i references për kullotën është 160 lekë/m²

Në dijen time për shpronësim çmimi përcaktohet nga :

- Zëri kadastral i pasurisë
- Në këtë rast sipas kategorisë së tokës bujqësore.

- Çmimin e references i përcaktuar nga Ministria e Financës në kohën e shpronësimit .
- Çmimin e tregut .

Pra në sqarimin e këshillit bashkiak mbi përcaktimin e çmimit nuk janë marrë parasysh këto kritere ligjore.

Njëkohësisht "Miratimi i këtij Vendimi" nga Prefekti i Qarkut është bërë apriori , pa shqyrtuar bazën ligjore dhe kriteret e mësipërme , sipas n.q.se ka, mbi relacionin e bashkisë bashkëngjitur këtij Vendimi

Për sa më sipër kërkoj Vendosjen për shpronësim me çmimin real dhe ligjor të pasurisë .

Gjithashtu ju bëj me dije se do të ndjek të gjithë rrugën ligjore për të drejtën time mbi pronën.

Me respekt

Mujo Ruçi



Libohovë më 17.03.2026